

BIBLIOTEKA

E

81H - 1

P. 83

GJIROKASTËR

SHTETIT

YLLI POLOVINA

neper  
stacione

vjersha dhe poema

891. P83-1

S

P. 83

YLLI POLOVINA

# NËPËR STACIONE

*(vjersha dhe poema)*

~~56147~~  
14188

BIBLIOTEKA E SHETIT  
GJIROKASTER

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## PARTIZANI DHE TOKA

Me bajonetat e nxira,  
nën muzg,  
varrin ja bënë shpejt e shpejt mbi pjerrinë.  
Toka në gji e mori partizanin  
sikur pak nga përjetësia e saj desh t'i jepte.  
Kaluan kohërat.  
Atje një lapidar i bardhë u ngrit një mesdite.  
Tani  
partizani pak nga përjetësia e tij po i jepte  
tokës.

## MESNATAT

Janë kaq të bukura ato mesnata  
me çarçafë të zhubrosur,  
me fletëza letre të shpërndara mbi  
tavolinë,  
me kokën midis duarve,  
i vetëm,  
i pagjumë,  
ndërsa mbas dritares  
e madhe  
rri  
hëna.

## M'U KUJTUA DIKUSH

Ka dy ditë që ky shi s'po rresht fare.  
Mbas dritares gjithnjë horizont i hirtë,  
çati të murrme,  
kalimtarë strehëve.  
I lodhur mbështeta kokën mbi xhamin, që  
nisi të ngrohej dalëngadalë;

Mbas xhamit  
edhe horizonti,  
çatitë,  
kalimtarët  
u ngrohën.  
M'u kujtua një partizan.

## DY PRANVERAT

Kështu vjen pranvera.

Bisqet çajnë koren e ashpër dimërore,  
lulet e purpurta çajnë bisqet e njomë...

Drejt qiellit duke u dridhur zgjaten,

bisqe e lule,

si mijëra gishtrinjtë të gjelbër, që diçka kërkojnë të  
kapin...

Rrotull shtyllat e tensionit të lartë çajnë

relievin e ashpër,

izolatorët e bardhë çajnë shtyllat,

telat e ndezura nisin vrapin...

Edhe gishtrinjtë metalikë sikur kërkojnë diçka të

kapin...

Në ajër

duart e dy pranverave mpleksen for:

## P R O M E T E J T Ë .

Mauzoleu ka rënë në heshtje.  
Mbi qetësinë e bardhë të mermerit,  
dy bredha fëshfërijnë si nëpër ëndërr.  
Ngjis shkallën e parë:  
dëgjoj një «këtu» të largët tek afrohet...  
Shkallën e dytë:  
«këtu-ja» po rritet...  
Shkallën e tretë:  
«këtu»,  
pastaj «këtu»,  
«këtu»,  
«këtu»...

Atëhere,  
midis shokësh i gjetur  
ngrita grushtin përmbi ballë,  
thashë:  
këtu!

Eci midis varreve të bardha të dëshmorëve,

varre me emra të gjatë,  
varre me emra e mbiemra të shkurtër,  
dhe midis:

varri i një partizani fotografist të vvarë.  
Përkulem.

Të duket sikur shoh dhjetëra kuadro të  
bardha,

të marra me kujdes.  
në filmin e fundit të larë,  
të gjetur në çantën e fotografistit të vvarë.

Sa trupa mbetën maleve,  
të varrosur shpejt e shpejt nën thëllimet  
dimërore!

Partizanë me moshë të re,  
partizanë me moshë të thyer.  
Atëhere nëpër qytetet e djegura dhe të  
shkretuara,

gjithë natën,  
aty-këtu,  
dëgjoheshin muret e gërmadhëve që binin.

Netë plot kryqëzime armësh,  
plot kryqëzime të shkurtëra e të shpejta  
flakësh:

Sa të sigurt ecët ju,  
mbi tokën e zhveshur,



nën qiellin e lakuriqtë,  
zbathur,  
trupave të përgjakur të maleve duke u  
hipur e zbritur.

Mbi konturet e përthyera të kohës  
binit  
një këtu,  
një atje.

Liria ju mori mbi supe si gjithnjë,  
ju solli drejt nesh,  
prometej të rinj,  
prometenj partizanë.

Të renditur edhe këtu njëshkolonë.  
të bardhë,  
ju flini të qetë të përkundur nga përjetësia,  
kështu do të rreshtohemi në një ditë,  
bashkë,  
në qoftë se malet do të përcjellin oshëtimën  
e dikurshme

tri pushkë,  
një bombë.

## DASHURIA

Ndoshta edhe në llogore do të na gjejë,  
çapkënja gazmore,  
dashuria.

E stolisur me lëndina vjollcash, cicërима zogjsh,  
gurgullima të kristalta burimesh,  
e ngarkuar me ëndërra, ankthe, të puthura  
dashnorësh;

E bardhë,  
te ne do të vijë.

Dhe kur të na gjejë fytyrë e trup  
nxirë nga tymi i betejave,  
do të na shohë njëherë në sy të gjithëve,  
pastaj dikujt do t'i marrë një pushkë  
dhe pranë nesh do të shtrihet në llogore.

## TI

Në një mbrëmje pa njerëz,  
si një autobus i hirtë tranzit kalon pa u ndalur  
në një qytet të vogël,  
elegante dhe mospërfillëse u shfaqe dhe u zhduke  
ti;

Mbas s'mbeti veç një re e hollë pluhuri  
dhe një kujtim i keq,  
si një paketë «diamant» bosh, i zhubrosur,  
me indiferencë i flakur nga një dritare e tranzitit.

## NË PARK

Midis një parku  
tërë gaz disa fëmijë po këpusnin lule për një  
delegacion.

Mblidhnin dy me petale ngjyrë alle,  
një të vogël me thekë të blertë,  
disa me gjethëza e gonxhe të purpurta...  
E ashtu si pikat e shiut thyejnë dritën e diellit  
në një mesditë,

u shfaq një shirit i kuq,  
një i blertë,  
një i kaltër;  
në duart e njoma nisi lehtë të fërgëllonte një  
ylber  
i vogël lulësh.

Ylberi pastaj u rrit ngadalë drejt qiellit  
duke puthur butë fëmijët dhe horizontin.

## MBI TRUNG

U ulëm mbi një trung,  
unë  
dhe ti që qeshje e qeshje, e dashur.  
Ç'thoshte ajri që dridhej e dridhej si i gjallë?  
Ç'thoshte perëndimi, që digjej larg,  
gjurmat në bar ç'thoshin?  
Dikush po i ngjitej malit  
kurse mbi supet tona,  
nëpër feksjet e heshtura të muzgut  
era po shpupuriste flokët e mjegullës  
që po vinte.

## L A R G I M I

Fishkëllimat e fundit.

Tutje mbi xhamin kristal të dritares së  
vagonit

po perëndonte i kuq dielli.

Konduktorja e fundit u shkëput nga  
platforma.

Treni u nis.

Tutje mbi xhamin kristal të dritares së  
vagonit

dielli perëndoi.

Iku dielli.

Ike  
edhe ti.

## NJERIU I DRITARES

Mbas një dritareje me perde të rënda,  
si mbas një xhami të ftohtë optik,  
bashkë me muzgun,  
gjithnjë endet një njeri, sytë e vegjël duke  
picërruar.

Jashtë bota lëviz pa fjalë,  
jashtë bota tkurret e deformohet  
në një pikë.

Tani punëtorët e uzinave ndërrojnë turnin,  
elektrifikohet edhe një fshat;  
hidrocentralet gëlltisin nga relievi rrjedhat e  
bardha të ujit,  
nëpër dejt e atdheut urbanët marrin dhe lënë  
njerëz,  
ndërsa njeriu mbas dritares,  
për «vetushqim shpirtëror»,  
sytë e vegjël ja ka mbërthyer reve dimërore.

Tani punëtorët po kthehen nga shkollat e natës.  
nënat vënë në gjumë fëmijët e shëndetshëm,  
inxhinierët përthyhen mbi projektet e së ardhmes,  
por njeriu i dritares lëviz nervoz,  
kërkon diçka të fiksojë,  
shkruan vargun e parë,  
të dytin,  
vargjet si kolona ushtarësh pas një kapitullimi  
dalin të zinj,  
të zyrtë.

Mbas xhamit të ftohtë optik,  
ku peisazhet thyhen në mijëra copëra të vdekura,  
ky njeri diçka kërkon të shkruajë këtë natë.

Mbi ballin e ftohtë lëvizin ngadalë  
pejsazhet me shi,  
gjethe vjeshte që vërtiten pa fund,  
pellgje të turbullt buzë rrugëve,  
vajza me sy të lagët.  
Vijnë që të gjitha rëndë-rëndë,  
si ajsbergë të frikshëm në një mugëtirë,  
një pjesë mbi det,  
nëntë nën ujë.

Mbas një dritareje me perde të rënda,  
si mbas një xhami të ftohtë optik,  
gjithnjë endet ky njeri sytë e vegjël duke  
picërruar...



Por sot  
po vijnë punëtorët.  
Me grushtin e fuqishëm xhamat ja thyen, si të  
copëtonin një lakrimar,<sup>1)</sup>  
ja dogjën peisazhet e ftohtë, që u endën nëpër  
dhomë  
dhe e morën këtë njeri në mes të automjeteve,  
tornove e turbinave.

«Këtu po munde, rro!»  
I thanë.

---

1) *lakrimar* — enë, ku zonjat mondane ruanin lotët që derdhnin për dashnorët e tyre.

## BUZË RRUGËS

Buzë rrugës,  
sot elektrikistët montuan një reklamë.  
Poshtë,  
duke hedhur hapat sipas ndriçimit të saj,  
endem.

Gjithshka ngjante me ty, e dashur, këtë  
natë.

U ndez në fillim shkronja e parë,  
pastaj e dyta,  
e treta,  
dhe elektriciteti skuqi të gjithë emrin më  
në fund.

Dritë verbuese për një çast.  
Pastaj e gjitha u shua.  
Mbetën vetëm konturet e shkronjave, që  
ftoheshin  
dhe kujtimi yt.

## G J Y S H E S

Duke shtypur heshtjen e trotuarit të asaj nate,  
erdha.

Rrotull vetmi të pakuptueshme pemësh,  
rrotull vetmi stacionesh,  
kalimtarësh.

Erdhë mes asfaltit të lagur, që po thahej  
vende-vende,

ndërsa sipër,  
supeve,

pemët më shkundnin pikat e mbetura të shiut.

Ku ta gjej atë, që e lash kur ika?

Ku ta dëgjoj zërin, që dikur e dëgjoja?

Atë që më puthte sa herë që nga larg vija,  
gjyshen time?

Dhoma e saj është e zbrazët e gjitha.

Vetëm herë-herë nëpër të

enden jehonat,

vetëm jehonat, që përpëliten,

si lakuriqë nate nëpër muret e lagështa të  
dhimbjes.

Vdiq një gjyshe,  
vdiq një nënë,  
vdiq një shqiptare.  
Hoqi kapelën e reve qielli,  
heshti.

O gjyshet tona,  
që pas bijve tuaj u endet maleve,  
zbathur,  
që bustina partizane qepët netëve,  
të uritura!  
E duke vrapuar pas bijve i morët të gjitha,  
kush azmën,  
kush tuberkulozin,  
kush dha edhe jetën.

Mbi varrin tënd tani endet era e fushës, gjyshe.  
Dheu është i freskët akoma,  
unë ulem dhe lë një tufë lulësh mbi të.  
Qofsha si ti, gjyshja ime,  
e ndjeksha Partinë si ti ndoqe birtn tënd.

Flas unë, nipi yt, gjyshe.  
shihmë!  
A s'më sheh?  
kam vënë grushtin e rëndë përmbi ballë.

## TI DHE HËNA

Në kubënë e yjëzuar të horizontit  
hëna,  
me përplasjen e heshtur dhe të gjatë të  
dritës,  
si zog i artë,  
për diku mendohet të ikë këtë mbrëmje.  
Hëna mbeti,  
e madhe dhe e ngrohtë,  
atje.

Sipër ecën hëna.  
Poshtë  
ecim edhe ne, e dashur.  
Ti flokët ke lëshuar mbi supe  
dhe qesh.  
Anës rrugës  
pellgje tek-tuk  
e nëpër to

një hënë e ftohtë na ndjek.

Kurrë mos na vështroftë hëna nga lëkundjet  
e turbullta të pellgjeve,  
nga lart,  
supeve na ndriçoftë gjithnjë iluminishenca  
e saj, e dashur.

Ja,  
hëna po ulet mbi kaçurrelat e tua,  
hëna dhe ti për një çast të bashkuara në  
një pikë...

Flokët po të marrin zjarr...  
Tani më duket se kam para një galaktikë të  
pafundme yjesh, që digjen  
dhe dua  
kokën ta mbështes në pafundësinë e tyre.

## IKJA

Mendimet sot më duken  
si shkëmbenj që rrokullisen nëpër pjerrësinë  
e një mali  
dhe me rropamë ngelen  
aty,  
këtu,  
të rëndë,  
të hirtë.

A nuk ndodh kështu edhe me lotët?  
Mbijnë kaq befas prej syve,  
pastaj rrokullisen e rrokullisen  
dhe ngelen  
disa flegrave, që dridhen,  
disa mollëzave, që digjen,  
disa buzëve.

Si ike kështu?

Kish njerëz,

të të puthja s'mundja,

të të jepja s'dija çfarë

dhe atëherë heshta,

heshta

dhe vetëm dorën tunda,

pas.

U dashuruam

midis zhurmës së kaq e kaq karrocave që

lëviznin,

midis kaq modinash majtas e dajthtas,

midis tokmakësh që godisnin.

Dhe morëm prej të gjithave nga pak, e

dashur,

pak zhurmë karrocash,

pak thirrje komandantësh,

grumbuj dherash,

kallo.

Ti ike.

Pasi si i le kaq shpejt të gjitha,

të qeshurat e çiltëra,

lëkundjet e flokëve,

shkallët e pjerrta që ngjiteshin në rrugë,

asfaltin...

Kaq shpejt të gjitha si munde t'i lesh?



S'më mbetet veç të mbledh jehonat tani,  
disa trasesë,  
disa arkave ku uleshim,  
sheshit të flamurit,  
buzëmbremjeve,  
andej,  
këndeje,  
dhe t'i lëshoj të lira hapësirave,  
përsëri.

Tani

jam ulur në vendin ku rrinim gjithnjë.

Është vonë.

Dhe të ëndërroj, aksionistja ime,

duke zbritur ato shkallë të pjerrta që

bashkonin rrugën me sektorin,

si imazh i bardhë, që zgjerohet e zgjerohet

drejt një horizonti të kaltër, të njohur,

të pafund.

## URBANËT

Mëngjezi u zbulon një nga një supet e metalta  
urbanëve.

Aty-këtu  
u lë brymën e brishtë mbi karroceri, anës  
dritareve,

me vesë të ftohtë vesh xhamat, rrotat...

e ata zgjohen,  
dridhen lehtë si nga një gëzim i pakuptueshëm,  
fërgëllojnë;

Është një start i çuditshëm ky i urbanëve çdo  
mëngjez,

start urbanistik,

start industrial.

Urbanë të markave e të gjatësive të ndryshme,  
shumëngjyrësh,

me shofera të gjatë të shkurtër, të trashë,  
që gjithnjë ndalen për të marrë njerëz.

buzë trotuareve,

në tabelat e bardha,  
«Stacion autobusi 2»  
«Stacion autobusi 4».

Qëllon që njerëzit janë të shumtë,  
dyertë automatike mezi mbyllen,  
karrocëritë

rëndë

mbi asfalt

përkulen,

por asnjëherë s'u ankuat, miq të metaltë;

Zemërgjerë na pritët kudo.

ashtu siç ishim,

me shi,

me vajra,

me baltë.

Vrapues të palodhur të kësaj epoke të madhe,

me targa me katër shifra,

që për jetë doni të bashkoni.

apartamentet,

trotuaret,

P T T-të, teatrot, mapot,

me konturet e hekurta në uzinat jashtë qytetit.

Kush nuk e ndjen vallë zhurmën tuaj midis  
gjithë zhurmave të tjera,

herët mëngjezeve,  
netëve të vona?

Tek ju ndodhi që nisën fillin dashuritë tona  
e ju pa fanatizëm na çuat kudo,  
na shëtitët kinemave, teatrove,  
kudo  
në të largëtën periferi.

Ndodhi që na latë ndonjëherë jashtë qytetit,  
mbi asfaltin e heshtur,  
nën tabelën e bardhë «Stacion autobusi 6»,  
por kurrë s'u zemëruam,  
mbetëm miq të mirë, shokë të metaltë.

Do të vijë koha që do t'ju heqim përgjithmonë  
nga peisazhet e bardha të qyteteve,  
do t'ju çojnë të rimorkjuar në një vend të qetë,  
në ndonjë buzë rruge,  
mbrapa ndonjë ofiçine.

Do të rrini,  
atje.

Në çdo rrudhë ndryshku që do t'ju formohet,  
në plasat e gomave të kalbura,  
mbi xhamet e thyera e të mbetur  
pezull,

do të shfaqen zhurmat e bardha të qytetit,  
skeletet e kantjereve,  
korpuset e gjata të kombinateve  
dhe herë-herë,  
edhe ato që bashkë s'i harrojmë,  
dashuritë tona.

Asfalteve do të duken urbanë të rinj,  
targa të reja me gjashtë e tetë shifra,  
njerëz të rinj do të presin nën tabelat e bardha  
«Stacion autobusi 2»,  
«Stacion autobusi 4».

E për jetë do të mbeten të bashkuara  
apartamentet e trotuaret,  
PTT-të, kinematë, mapot, teatrot,  
me uzinat jashtë qytetit.

## KUJTIMET

Pista mbeti bosh.  
Orkestra heshti.  
Pa fjalë,  
kamarjerët mbledhin pjatat tavolinave.  
Mundohem edhe unë të mbledh ndodhitë e  
fundit  
dhe si kamarjerët vetmitë e pjatave  
mblodha në një pirrg  
kujtimet e largëta  
këtë natë.

Tërë zhurmë,  
sapo u larguan maturanët e këtij viti,  
duke lënë si edhe ne atëherë,  
të shpërndara  
vetmi pjatash,  
vetmi gotash,  
lulesh e fletësh të zhubrosura,

vetmi të çrregullta karrigesh...  
Duke lënë si atëhere ne  
heshtjen e zbrazët,  
pistën  
bosh.

Në skaj,  
tavolinat mbetën të bashkuara fort.  
Vetëm tavolinat të bashkuara  
në gjithë atë vetmi  
të ndarë  
mbetën sot.

Mbrëmja e «Lamtumirës».  
Ishte po ajo pistë  
këto tavolina të bashkuara diku në skaj,  
këta kamarjerë,  
këta orkestrantë  
dhe rrotull,  
njerëz që na buzëqeshnin e buzëqeshnin pa  
fund,  
nëpër tinguj,  
atë natë.

Eh, kujtime shokësh të mirë e gazmorë,  
kujtime fytyrash që qeshin e që të vërtiten  
tërë gaz nëpër kujtesë,  
fytyra të mbushura,

fytyra të hequra,  
shkumbëzime të bardha birrash,  
doli...  
Nën flokët e rrapeve të vjetër.  
Në pistë.

Pinim lamtumirat  
me gotat,  
me krikat,  
me shakatë  
dhe aty-këtu  
edhe me lotët.

Jetë gjimnazi,  
ushtrime të zgjidhura e të pazgjidhura çdo  
ditë,  
shkëmbime librash,  
mbledhje organizate deri vonë,  
pusullka,  
orë bosh,  
lumturi  
kaq shumë!

Diku,  
Arbeni ndodhet tani në praktikën mjekësore.  
I bardhë  
vërtitet i shpejtë nëpër pavionet e heshtura  
të ndonjë spitali



a poliklinike.

Diku,

si numër i bardhë telefoni nën gishtin e  
djersitur,

bashkë me receptorët që ngrihen e ulen,  
dëgjohen

uturimat e autoambulancave.

Kthesë.

Bashkë me barrelat

mjeku ynë

i pagjumë.

roje rri.

Ndoshta këtë çast Rifati merr turnin e natës.

ka dalë nën tabelën e stacionit

dhe i menduar

pret.

Novacionin duhet të vejë në jetë

që sot.

Nën tabelën e stacionit,

i menduar,

miku im, tornitor, ndoshta,

pret.

Mira,

prisje lindjet që feksnin horizontit

e perëndimit,  
t'i doje të vrapoje kreshtave të maleve.  
Mira,  
ti tashmë, je artiste.

Ja edhe Bashkimi.  
Mbi supet e fortë  
bota me ndërtesat, kullat,  
korpuset gjigande të kombinateve.  
TEC-eve...  
Mbi supet e inxhinierit  
Konstruksioni më i bukur,  
më i forti,  
industrializimi,  
qëndron

Larg.  
Vallë ç'mendon Agimi në kufi?  
Tani,  
në heshtjen e nderur të natës kufitare,  
në përgjim,  
me siguri, miku im  
mendon për ne.

Dhe u ndamë,  
ja lamë përshtypjet njëri-tjetrit nëpër bloqe,  
shpejt e shpejt.

Dhe ikëm një ditë  
kush auditoreve,  
kush uzinave,  
kush kufirit. . .

Ikëm. . .

Karriget i lamë në vetminë e çrregullt.  
të ftohtë,  
të pakuptimtë.

Mes jush

kalova, si një vinç i madh kalon nëpër qytet,  
shokët e mi.

Dhe s'di se si  
nëpër kokë

më mbetën,

ashtu si vinçit degë të këputura rrugëve,  
këto kujtime të gjelbërta.

I shkunda të gjitha,  
po iki.

Tutje po kalon urbani i turnit të natës.

## KISHA E BRAKTISUR

Atje buzë lumit rruga bën kthesë  
e kamionët e rëndë formojnë shtjella pluhuri,  
E futur në shkëmb,  
e hirtë,  
si e skrupullosur nga një makth i padukshëm,  
qëndron një ndërtesë  
me sytë e zbrazët të fiksuar në një pikë të  
mjegullt.

Prej kohësh të errta,  
këtu,  
dora prej meiti e obskuracionit  
u vërtit një kohë nëpër ajrin e ftohtë buzë  
lumit  
dhe një ditë,  
kalimtarëve të lodhur  
u doli përpara nëpër natë,  
një kishë.

Në fasadën e ftohtë të kishës,  
kishte një kube  
me gojën si të çapëlyer nga tmerri  
dhe një Shën Mëri të zbehtë të gërvishtur mbi  
mur.

Binin currilat e holla të ujit  
Nën dridhjen e rrathëve, që formoheshin,  
sipërfaqja e ujit.

poshtë  
lëkundej.

Si në syrin e lagët të një sëmuri nga ethet  
kulmohej e ulej,

me ngërç,  
Shën Mëria.

Dhe po atë ditë nëpër shkallaren në brinjë  
u duk edhe pjella,

një prift,  
sterrë.

Ecte prifti,

ecte edhe hija në heshtje.

Diku prifti dhe hija

në një përqafim ogurzi  
përkuleshin

mbi altar.

Prifti.

Hija.

Ky kryqëzim i tmerrshëm endej nëpër truret  
e lodhura të njerëzve,  
nëpër funeralet e zinj dhe memecë, që i nxirr-  
nin rrugicat,  
nëpër varret e porsahapura faqeve të lagta të  
kodrinave,  
nëpër alkoolin, që derdhej dasmave të dehura  
pranë shtatzaneve

rrinte

dhe mbi mishin e butë të foshnjës që sapo  
lindte.

ky kryqëzim  
ngulej  
i fiksuar në një kryq.

Nën kubënë e ftohtë  
Currilat vazhdonin të binin.  
Një nga një.  
Rrathët hapeshin si gojë përbindëshi  
e bashkë me to  
Shën Mëria  
shtrinte drejt njerëzve

krahët.

Vinte kalimtari i etur buzën te currili,  
pinte një gllënkë,

edhe një.

Uji i rridhte nëpër mjekër  
si lak i akullt gjarpëri i rrotullohej nëpër qafë  
e rëndë

rrëzohej në rezervuar.  
Mundohej të pinte më  
por s'mundej.

Poshtë lëmyshqeve  
ja ngulte sytë e jeshiltë  
Shën Mëria që zgjerohej e tkurrej.

Anës murit prifti ngjiste e zbriste shkallaren  
e ngurtë nën muzg.

Jehonin hapat...

Hija rrëshkiste mbi mur,  
e ngrirë  
si në sfond të gijotinės

xhelati.

Koha rrodhi;  
koha vërshoi.

Njëherë,  
poshtë currilit e Shën Mërisë  
dikush pështyu,  
dikush mallkoi.

Koha rrodhi,  
koha shpërtheu.

Njëherë,  
nëpër qetësinë e një meshe,  
dikush rebeloi,  
dikush një ikonë theu.

Nëpër stola  
besimtarët rralloheshin të dielave  
dhe në vend të tyre  
bersaljerë  
nën «Vinçeremon»  
vinin.

Me shkëlqimin e bekimeve vinin e niseshin  
tërë gjak e të përgjysmuar ktheheshin.  
Helmetat sillnin shtrembërimin e peisazheve të  
stinave,

gratë e martirizuara,  
fëmijët e djegur...  
Shën Mëria atëhere mundohej t'i qetësonte e  
t'i niste përsëri.

Dhe vërtet «qetësoheshin»,  
grumbuj-grumbuj,  
maleve,  
periferive,  
pritave.



Nëpër helmëta,  
aty-këtu  
vrëma.  
Nëpër krahërore  
medaljone të shpuar,  
kryqe.

«Për emër të atit, të birit e të shpirtit të  
shenjtë».

si lakuriq nate,  
përplasej nëpër faqet e mureve të kishës e në  
ndërgjegjet e njerëzve,

por ndërkaq,  
nga turma  
dikush «Poshtë fashistët!» thirri;  
dikush pas,  
re traktesh  
la.

Koha rrodhi,  
koha vërshoi.  
Njëherë,  
poshtë currilit e Shën Mërisë  
një këngë e fortë u dëgjua  
një batalion partizanësh marshoi.  
Muuzg.  
Prifti.

Hija.

Duke u zvarritur bashkë me kryqëzimin,  
edhe një «mik»

«Për emër të atit, të birit e të shpirtit të shenjtë»,  
si lakuriq nate,  
përplasej nëpër faqet e mureve,  
në agoni.

Nëpër stola  
besimtarët rralloheshin gjithnjë të dielave,  
kalimtarët pinin pa frikë te currili  
se edhe Shën Mëria,  
poshtë lëmyshqeve,  
u nxi  
e trajtë humbi fare.

Në anë prifti zbriti edhe një herë shkallaren  
e ngurtë nën muzg,  
rrotull i dolën si në një valle hakmarjeje,  
korpuse gjigandësh kombinatesh,  
heshta oxhaqesh,  
TEC-e  
jehona të fuqishme turnesh...  
U drodh prifti,  
duart ju lëshuan  
e nga duartë i ra  
kryqi.

Koha rrodhi,  
koha vërshoi.  
Njëherë,  
në meshën e braktisur  
me bojë të kuqe  
«Poshtë feja!»  
«Rroftë Partia!»  
dikush shkroi.

Kohërat u thyen në gjunjët tanë  
një ditë,  
gjithshka u copëtua nga kjo kishë.  
Dhe nëpër copërat e ngjyera të xhameve,  
të ikonave  
u përpëlit dhe mbeti  
Shën Mëria.

Si një fosile ka mbetur sot kisha,  
e lënë nga një përbindësh që iku nëpër natë.  
Këtu s'qëndrojnë më as udhëtarët;  
Çezma ka shterruar;  
kamionët e rëndë i hedhin shtjella pluhuri.

---